



Vaksina shpëton jetën
Vaccination saves lives



Vaksinimi kundër COVID-19

Udhëzues për të gjitha gratë që
planifikojnë të ngelen shtatzënë,
që janë shtatzënë ose që ushqejnë
me gji

Janar 2022



GIG
CYMRU
NHS
WALES

Albanian

Vaksinimi kundër COVID-19 rekomandohet fort për gratë shtatzëna dhe gratë që ushqejnë me gji.

Është vërtetuar se vaksinat kundër COVID-19 që janë aktualisht të disponueshme në Mbretërinë e Bashkuar janë të efektshme dhe janë mjaft të sigurta. Është e rëndësishme që gratë shtatzëna të vaksinohen sa më shpejt të jetë e mundur, që të mbrojnë veten dhe fëmijën e tyre.

Cilat janë këshillat për vaksinat kundër COVID-19 gjatë shtatzënisë?

Komiteti i Përbashkët për Vaksinimin dhe Imunizimin (JvCI), një grup ekspert i pavarur, ka këshilluar se gratë shtatzëna janë më të rrezikuara ndaj pasojave të rënda prej sëmundjes COVID-19. Është e rëndësishme që gratë shtatzëna të vaksinohen plotësisht sa më shpejt të jetë e mundur. Ato nuk duhet të presin derisa të lindin që të bëjnë vaksinën. Arsyeja për këtë është që të mbrojnë veten dhe fëmijët e tyre.

Qindra mijëra gra shtatzëna janë vaksinuar me vaksinat Pfizer ose Moderna në Mbretërinë e Bashkuar dhe nuk janë identifikuar rreziqe. Vaksinimi është shumë i efektshëm në parandalimin e rasteve të rënda me COVID-19. Këto vakcina nuk përmbajnë koronavirus të gjallë dhe nuk mund ta infektojnë një grua shtatzënë ose fëmijën e saj në bark.

Çdo grua që e ka nisur tashmë vaksinimin dhe të cilës i është ofruar një dozë e dytë ndërsa është shtatzënë, duhet të bëjë një dozë të dytë me të njëjtën vaksinë, përveç nëse ka pasur ndonjë efekt anësor të rëndë pas dozës së parë.

Cilat janë rreziqet e sëmundjes COVID-19 gjatë shtatzënisë?

Nëse sëmurëni me COVID-19 në fazat e vona të shtatzënisë, si ju, ashtu edhe fëmija juaj ka të më tepër gjasa të sëmurëni rëndë dhe të keni nevojë për shtrim në spital dhe për kujdes intensiv. Të dhënat në Mbretërinë e Bashkuar tregojnë se thuajse çdo grua shtatzënë që është sëmurur me COVID-19 dhe ka pasur nevojë për shtrim në spital ose për kujdes intensiv, nuk ka qenë e vaksinuar.

Gratë shtatzëna me problemet mjekësore të mëposhtme janë më të rrezikuara që të vuajnë nga komplikacionet e rënda prej COVID-19:

- problemet me sistemin imunitar
- diabeti
- tensioni i lartë i gjakut
- sëmundjet e zemrës
- astma e rëndë

Ose nëse jeni:

- mbipeshë
- mbi moshën 35 vjeç
- në tremujorin e tretë të shtatzënisë (mbi 28 javë)
- ose me prejardhje etnike minoritare zezake ose aziatike
- e pavaksinuar ose e vaksinuar pjesërisht

Rreziku i përgjithshëm nga sëmundja COVID-19 ndaj jush dhe fëmijës suaj është i ulët, por ai është rritur që prej valëve të para të COVID-19.



Çfarë do të thotë kjo për mua?

Nëse jeni shtatzënë, vaksinohuni sa më shpejt të jetë e mundur. Ju duhen dy doza të paktën 8 javë larg njëra-tjetrës. Nëse i keni bërë tashmë dy dozat e para, ju duhet një dozë përforsuese të paktën 3 muaj pas dozës së dytë.

Vaksinat kundër COVID-19 gjatë shtatzënisë ju japin mbrojtje të lartë nga sëmundja e rëndë.

Nxiteni që të lexoni vendimin e Kolegjit Rojal të Obstetërve dhe Gjinekologëve në këtë link: rcog.org.uk/covid-vaccine. Informacioni në të mund t'ju ndihmojë të merrni një vendim të informuar. Nëse keni pyetje të mëtejshme, flisni me maminë ose mjekun tuaj të përgjithshëm.

A mund ta bëj vaksinën nëse ushqej me gji?

Dobitë e të ushqyerit me gji dihen qartë. Këshilla eksperte nga JCVI dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO) është se vaksina mund t'u jepet grave që ushqejnë me gji. Nëse ushqeni me gji, ose planifikoni të ushqeni me gji, mund të vazhdoni të ushqeni me gji edhe pasi keni bërë vaksinën.



Vaksina dhe fertiliteti

Nuk është e nevojshme të shmangni shtatzëninë pasi keni bërë vaksinën për COVID-19.

Nuk ekzistojnë prova se vaksinat kundër COVID-19 kanë ndonjë efekt te fertiliteti juaj apo te mundësia për të ngelur shtatzënë.

A ka efekte anësore vaksina?

Njëlloj si të gjitha barnat, edhe vaksinat mund të shkaktojnë efekte anësore. Arsyeja për këtë është se vaksinat funksionojnë duke shkaktuar një reagim në sistemin tuaj imunitar. Shumica e tyre janë të lehta dhe zgjatin vetëm pak ditë, dhe nuk u shfaqen të gjithëve.

Ju lutemi të lexoni fletëpalosjen “Çfarë duhet prisni pas vaksinimit kundër COVID-19”, e cila gjendet këtu: phw.nhs.wales/covid-vaccine-what-to-expect

Çfarë duhet të bëj?

Do t'ju tregohet se kur dhe ku ta bëni vaksinën. Në ditën e takimit, vishni rroba praktike në mënyrë që ta zbuloni me lehtësi pjesën e sipërme të krahut. Nëse nëse keni frikë nga gjilpërat ose ndiheni në ankth, tregojini personave që ju bëjnë vaksinën. Ata do t'ju kuptojë dhe do t'ju ndihmojnë.

Që të jeni sa më të mbrojtur për kohë të gjatë, është e rëndësishme që t'i bëni të gjitha dozat e vaksinës. Mbajeni kartën në vend të sigurt dhe sigurohuni të bëni dozën e dytë dhe më pas dozën përforcuese.

Çfarë duhet të bëj në ditën e takimit?

Nëse nuk ndiheni mirë, është më mirë të prisni derisa ta keni marrë veten nga vaksina, megjithatë duhet të përpiqeni ta bëni sa më parë të jetë e mundur.

Nuk duhet të shkoni në takimin për vaksinën nëse jeni izoluar ose nëse po prisni të bëni testin për COVID-19 ose katër javë pasi keni marrë përgjigje pozitive nga testi për COVID-19.

A është e nevojshme të ndjek udhëzimet nëse kam bërë vaksinë?

Asnjë vaksinë nuk është 100% e efektshme, ndaj DUHET t'u përmbaheni të gjitha kufizimeve kombëtare dhe lokale, dhe:

- mbani maskë kur ju kërkohet
- lani duart me kujdes dhe rregullisht
- hapni dritaret që të qarkullojë ajri
- zbatoni udhëzimet që gjenden në gov.wales/coronavirus.

Mos harroni:

COVID-19 përhapet përmes spërklave që dalin nga hunda ose goja, sidomos kur flisni ose kolliteni. Gjithashtu mund të merret duke prekur sytë, gojën dhe hundën, pasi keni prekur objektet dhe sipërfaqet e kontaminuara.

Nëse keni pyetje ose nëse doni më shumë informacion, mund të vizitoni 111.wales.nhs.uk, të flisni me mjekun ose të telefononi NHS 111 Wales.

Nëse 111 nuk është i disponueshëm në zonën tuaj, ju lutem telefononi 0845 46 47. Telefonatat nga numrat fiks dhe celularët kushtojnë 2p në minutë (plus tarifa e zakonshme e ofruesit tuaj telefonik).

Më shumë informacion

Mund të gjeni më shumë informacion rreth vaksinave kundër COVID-19, duke përfshirë përmbajtjen e tyre dhe efektet e mundshme anësore, në: **coronavirus-yellowcard.mhra.gov.uk/productinformation**

Informacion i mëtejshëm dhe fletëpalosjet për pacientët mund të gjenden në: **phw.nhs.wales/covid-19-vaccination**

Mund t'i raportoni online dyshimet për efektet anësore në: **coronavirus-yellowcard.mhra.gov.uk** ose duke shkarkuar aplikacionin Yellow Card.

Për të mësuar më shumë rreth mënyrës se si NHS i përdor informacionet tuaja, vizitoni: **111.wales.nhs.uk/AboutUs/Yourinformation**

Për formatet e tjera të kësaj fletëpalosjeje vizitoni: **publichealthwales.org/HealthInformationResources**



© Public Health Wales NHS Trust, janar 2022
(me mirënjohje për Agjencinë e Shëndetit dhe Sigurisë në Mbretërinë e Bashkuar)

Versioni 3
ISBN 978-1-78986-154-666

